



Intervistë Q&A me Kejsi Kuzari

Kejsi, si një e sapo diplomuar e ciklit 5-vjecar universitar të Fakultetit të Inxhnjerisë dhe Arkitekturës, cila është arsyeja që zgjodhe të studiosh në Universitetin Metropolitan Tirana?

Pas përfundimit të gjimnazit të përgjithshëm “Sami Frashëri”, mundësitë për të zgjedhur ishin të shumta, por që ditën e parë që kam ardhur pranë universitetit vura re një prezantim serioz të programit që doja të studioja, patëm mundësi të takonim një pjesë të pedagogëve dhe të bisedonim nga afër rreth rrugëtimit që pritej. Gjithashtu, marrëveshjet me universitetet jashtë vendit, bursa 100% për studentët, kushtet komode të universitetit kanë qenë disa nga arsyet e zgjedhjes decisive. Vlen të përmend faktin se i gjithë dedikimi, përkushtimi, ekselencia pedagogjike, puna e palodhur e stafit ka qenë ashtu siç është përkrahur ditën e parë e deri në diplomim.

Si do ta përshkruaje atmosferën dhe kulturën e universitetit?

Cilat janë vlerat që shkolla promovon dhe si kanë ndikuar ato në përvojën tënde universitare?

Çdo ditë pranë universitetit është e mbushur me energji, ku pret me padurim cili do të jetë mësimi i rradhës nga shumëllojshmëritë e leksioneve që ky program ofron. Gjatë viteve akademike, ne kemi arritur të studiojmë dhe bëjmë projekte për tipologji të ndryshme ndërtimesh si vila, pallate, shkolla, hotele, objekte multifunktionale, konvikte studentësh etj., të cilat janë bazat e dijeve të shëndetshme të çdo arkitekti. Ne kemi pasur mundësi të punojmë dhe të shkëmbejmë njohuri me grupe të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare. Një prej tyre është zhvillimi i workshopit të projektit të uzinës së autotraktorëve, në bashkëpunim me studentë nga “Universiteti i Torinos”. Gjithashtu, së bashku me “Grimshaw Architects”, një studio arkitekturore angleze, ne kemi fituar çmimin e parë në të gjithë universitetet e Tiranës për implementimin e projektit “Design Together”.

Si e përdor teknologjinë dhe burimet dixhitale për të përmirësuar profesionin dhe organizmin e punës tuaj akademike?

Në fillim të vitit të parë, të gjithë studentët jemi pajisur me laptopë nga universiteti, ku kemi pasur mundësi të shkarkojmë programet e nevojshme të punimit të projekteve të ndryshme. Padiskutim, zhvillimi i teknologjisë është esencial në punën tonë si arkitektë dhe gjithmonë synojmë të ecim me hapin e kohës dhe të përshatemi me ndryshimet që tregu ofron. Programe të ndryshme me të cilat punoj janë: Autocad, Sketch up, Revit, Lumion, Enscape, Paketa Adobe (Photoshop, Illustrator, Indesign) etj., të cilat do ja sugjeroja studentëve t’i mësojnë gjatë viteve të studimit.

Si po përgatitesh për një karrierë pas përfundimit të studimeve?

A ke planifikuar praktika apo mundësi të tjera për të zhvilluar përvojën praktike?

Prej 2 vitesh, punoj në një kompani ndërtimi shqiptare, A.I.C, e cila më ka ndihmuar të zhvillohem krahas nivelit teorik të marrë në universitet edhe në atë praktik. Aktualisht po punojmë me një studio arkitekturore ndërkombëtare, OMA, me të cilën po zhvillojme projekte të ndryshme. Krahas saj, këtë vit do të jem dhe pjesë e stafit akademik të universitetit, si pedagog e lëndës gjeometri descriptive. Për studentët e ardhshëm do thoja se suksesi nuk vjen brenda natës, por progreset e vogla dita-ditës janë ato që sjellin rezultate të mëdha.